



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.06/2017

Prishtinë, më 18 dhjetor 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Mungoi: Frashër Krasniqi, Mytaher Haskuka dhe Mirjeta Kalludra.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Hilmi Jashari - Avokat i Popullit, Arsim Janova - U.D. kryesues i Bordit të ZRRE-së, Besim Sejfiqaj - ZRRE, Petrit Pepaj-ZRRE, Adelina Bajrami - ZRRE, Suzana Gashi-IAP, Ismail Shabani-KosovaPress, Gramos Paqarada-KDI, Teuta Prekazi - UN "Human Rights, Kaltrina Zymberi-Ekonomia Online, Faton Salihu-RTK dhe Elmina Osmani – RTK.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Diskutim lidhur me Raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjie elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, (të ftuar: Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Avokati i Popullit),
2. Të ndryshme.

1.Diskutim lidhur me Raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjie elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës

Kryetarja, në fillim të kësaj pike të rendit të ditës, ia dha fjalën U.D. kryesues i Bordit të ZRRE-së.

Arsim Janova tha se në emër të ZRRE-së do të referoj në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Nga 16 maji i këtij viti janë vetëm dy anëtarë të bordit dhe në bazë të ligjit për të funksionuar si bord dhe për të marrë vendime duhet të jenë së paku tre anëtarë.

Tha se në vitin 2012 është nxjerrë një vendim i cili ka afat vlefshmërie deri më 31 mars 2018, mirëpo Avokati i Popullit në muajin maj e ka hapur si rast çështjen e faturimit të energjisë elektrike në pjesën veriore.

Në qershor të këtij viti kemi pranuar një raport nga Avokati i Popullit, ku i ka paraqitur edhe tri rekomandime kryesore për Rregullatorin, por njëkohësisht edhe për Qeverinë, i kemi kthye një përgjigjeje Avokatit të Popullit, mirëpo me veprimet që ka kërkuar të ndërmerren urgjentisht, ne, si Bord i ZRRE-së, që nga 15 maji 2017, kemi theksuar se është jo funksional në aspektin e vendimmarrjes, në mungesë të anëtarëve të cilëve ju ka skaduar mandati.

Pas kompletimit të Bordit, në koordinim me Qeverinë do të kërkohet një zgjidhje sa më e pranueshme për këtë çështje.

Avokati i Popullit i ka vazhduar veprimet e veta në gjykatë. Gjykata Themelore ka atakuar vendimin nr. 399 të dt. 6 shkurt 2012, por njëkohësisht ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme, deri sa mos të vendoset në procedurë të rregullt sipas çështjes kryesore në shqyrtim meritore.

Më vonë, ashtu është dhënë edhe vendimi i gjykatës, shtyrja e ekzekutimit apo pezullimi i përkohshëm i atij vendimi derisa mos të vendos gjykata në procedurë të rregullt.

Si ZRRE, kemi shfrytëzuar të drejtën e ankesës, ka pasuar aktvendimi i gjykatës së apelit e cila e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

ZRRE çdo vendim që është i plotfuqishëm qoftë edhe si masë e përkohshme duhet ta zbatojmë, sepse është vendim gjyqësor.

Bordi i ZRRE-së kemi informuar instancat relevante, si, Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, si dhe Qeverinë, lidhur me impaktet.

Më tutje, më 30 nëntor 2017, ju kemi dërguar të licencuarve një shkresë, sepse ne nuk kemi mundur me marrë vendim, por një njoftim ku përfshihen edhe udhëzimet se si do të zbatohet një vendim i plotfuqishëm i gjykatës ku normalisht nga data 1 dhjetor 2017 është hequr pjesa diku 3.5% nga faturimi për pjesën veriore të Kosovës, kjo do të vazhdojë edhe më tutje, por mbetet se çka do të veprohet në të ardhmen.

Teuta Haxhiu, a i arsyetoni ju, si anëtarë të Bordit të ZRRE-së, humbjet e energjisë elektrike, dhe a thirreni prapë se janë humbje të arsyeshme dhe të lejueshme?

Duke e ditur mënyrën se si është zhvilluar procesi i privatizimit në KEK, edhe sa kohë duhet qytetarët të paguajnë fatura për mos kompletim të bordit apo mos dhënien e mendimeve profesionale të juaja si ZRRE.

Pse ju nuk e keni ngritur më herët këtë çështje dhe nuk i keni dhënë mendimet e juaja në mënyrë që të mos vije deri te kjo situatë, për 7 vite të paguhen 49 milionë euro që të gjitha janë paguar prej buxhetit të qytetarëve.
Propozimi i Avokatit të Popullit është që këto mjete të kompensohen nga një fond që quhet fondi për zhvillimin e veriut, a keni ju si ZRRE, ndonjë mendim rreth këtij propozimi?

Miljana Nikoliq tha se çështja e energjetikës është në kuadër të Marrëveshjes së Brukselit, përkatësisht të dialogut në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Raporti nuk është i plotë.
Në vitin 2009 furnizimi me energji elektrike në Veri ishte ndërprerë më gjatë se 20 orë. Me qëllim që të mos ndodhë katastrofë humanitare, Qeveria e Serbisë ka marrë vendim për ta furnizuar veriun e Kosovës.
Në vitin 2013, me Marrëveshje të Brukselit janë paraparë dy firma: Elektroekonomia e Serbisë – Tregtia dhe Elektroveriu, por këtyre firmave katër herë iu janë refuzuar kërkesat e tyre për regjistrim.
Veriu i Kosovës merr faturat nga Elektro-Kosova.
Po e përsëris, institucionet publike, personat privat, një pjesë e qytetarëve paguajnë faturat për Elektro-Kosovën, e cila na furnizon me rrymë.
Në bazë të informatave të personave kompetent të Elektro-Kosovës dhe Elektroekonomisë së Serbisë, edhe më tutje fusha e rregullatorit (rrjeti i tensionit të lartë) për Kosovë dhe Serbi është Elektrorrrjeti i Serbisë, tha ajo.
Për shkëmbimin e energjisë është e ngarkuar Elektrorrrjeti i Serbisë. Elektrorrrjeti i Serbisë është përgjegjëse për veriun të Kosovës.
Zyrtarët e Elektrorrrjetit të Serbisë duhet të konsultohen, në mënyrë që të konstatohet gjendja reale lidhur me furnizimin me energji elektrike të veriun e Kosovës dhe se pohimet që faturat e larta të energjisë elektrike në jug të Kosovës për shkak të veriut, janë të pasakta dhe pabazë.
Raporti është i mangët. Populli në pjesën jugore është i informuar gabimisht. Pas konsultimeve dhe bisedave me personat kompetentë të Elektrorrrjetit të Serbisë, duhet të shqyrtohet raporti dhe i njëjti do të jetë i kompletuar.
Elektro-Kosova është ndërmarrje që ka ekzistuar edhe para luftës dhe tash punon në veri të Kosovës, ndërsa me Marrëveshjen e Brukselit është dashtë të transformohet në Elektroveri.
Të dhënat ekzakte janë plotësisht të qarta për njerëzit e kësaj fushe si në Beograd, ashtu edhe në Prishtinë.

Duda Balje, pyeti se veriun e Kosovës nga kush është furnizuar me rrymë, nga Kosova apo nga Serbia?

Arsim Janova, duke u përgjigjur në pyetjen e parashtruar, theksoi se nuk është e vërtetë se Serbia e bën furnizimin e pjesës veriore të Kosovës me energji elektrike.
Energjia elektrike me të cilën furnizohet pjesa veriore e Kosovës është energji e prodhuar dhe shpërndarë nga sistemi elektroenergjetik i Republikës së Kosovës.
Sa i përket regjistrimit të kompanisë përkatëse për pjesën veriore të Kosovës, kjo nuk është bërë, sepse marrëveshja parasheh që regjistrimi të bëhet në bazë të ligjeve të Kosovës, ajo

kompani serbe ka aplikua për furnizim në MTI, por statuti i asaj kompanie nuk është në përputhje me ligjet e Kosovës.

Ne e bëjmë vetëm furnizimin me energji, mirëmbajtjen e bënë ajo kompani që është e pa licencuar dhe është ilegale dhe për këtë duhet që organet kompetente shtetërore të Republikës së Kosovës të veprojnë.

Sami Kurteshi, për mua është e rëndësishme një çështje, pse unë si qytetar jam i detyruar për të paguar për një person në veri të Kosovës i cili ka vrarë shokun tim!

Çështja tjetër është se cila marrëveshje ndërkombëtare më detyron si konsumator për të paguar rrymën e dikujt tjetër, pa marrë parasysh si quhet ajo marrëveshje. Më intereson të dijë si është duke u bërë pagesa e rrymës tani, me këto shtesa për veriun apo jo, nëse po pse nuk bëhet transparent edhe pse nuk është bërë përpara.

ZRRE a ka qenë e informuar për shumën e shprehur në përqindje, apo qoftë shifra absolute për atë që kemi paguar ne qytetarët.

Avokati i Popullit ka dhënë një propozim konstruktiv që të bëhet kompensimi nga fondi për zhvillimin e veriut, nëse ka humbje të energjisë, atëherë le të kompensohen nga ky fond që është i krijuar pikërisht për atë qëllim.

Miljana Nikoliq, theksoi se problem kyç në implementimin e marrëveshjes për energjetikë edhe më tutje paraqet mos përmbushja e obligimeve të Prishtinës për themelimin e dy kompanive serbe : Elektroekonomia e Serbisë – Tregtia dhe Elektroveriu.

NP, Elektroekonomia e Serbisë, ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e kompanisë në agjencinë e Kosovës (KARB). Katër herë janë refuzuar kërkesat për regjistrimin e kompanive energjetike serbe më veri të Kosovës.

NP Elektroekonomia e Serbisë, arsyet e refuzimit të kërkesave për regjistrim i ka cilësuar si të paqarta dhe paushalle, kështu që i ka dërguar kërkesë për rishqyrtim të vendimit në Agjencinë e Kosovës (KARB). Lidhur me këtë kërkesë nuk ka pasur përgjigje me kohë, kështu që Elektroekonomia e Serbisë ka parashtruar ankesë në Ministri për Tregti dhe Industri, si dhe në Gjykatën Administrative në Prishtinë, por deri më tash nuk ka marr asnjë përgjigje.

Arsim Janova tha se e përmenda edhe më herët se kompania serbe nuk i ka përmbush kërkesat që parashihen me ligjet e Kosovës.

Albulena Balaj tha se mendoj se kërkesave për licencim të atyre kompanive të cilat janë refuzuar, nuk duhet dhënë shumë rëndësi këtu sepse jemi duke trajtuar një çështje tjetër.

Vendimet e gjykatës duhet respektuar, por përpos kësaj, kush duhet të jep llogari pse është bërë kjo?

Nëse në Marrëveshjen e Brukselit shkruan që qytetarët e Kosovës duhet paguajnë energjinë e shpenzuar në komunat veriore, atëherë ky është skandal. Nëse përfaqësuesit e Kosovës eventualisht kanë bërë një Marrëveshje të tillë, atëherë duhet Qeveria të mirret me këtë çështje, e jo të paguajnë qytetarët, si dhe me çfarë të drejte përmes një Marrëveshje krijohen obligime të pa qena për një pjesë të qytetarëve, për shpenzimet e energjisë elektrike që kanë bërë qytetarë të tjerë.

Luljeta Veselaj tha se të gjithë qytetarët i kanë vërejtur fryrjet e faturave të energjisë elektrike, por nuk kanë mundur për të ditur saktë se çka është duke ndodhur.

Është një tejkalim i çdo norme në fryrjen e këtyre faturave dhe është në disproporcion me tregun e punës që aktualisht e kemi në Kosovë, sa më shumë që harxhohet energji elektrike qoftë në familje, qoftë në biznes, aq më të larta janë faturat e energjisë elektrike, pse duhet paguar rrymën që nuk e kemi shpenzuar, si i arsyetoni ju këto humbje, nga se u tha se humbjet komerciale kanë arsyeshmëri, atëherë cila është arsyeja e këtyre humbjeve, dhe si do të kompensohen qytetarët të cilët kanë paguar rrymë që nuk e kanë harxhuar vetë?

Kompensimi nga pjesa e fondit zhvillimorë të veriut, që është rekomandim i Avokatit të Popullit, mendoj se është rekomandim i qëlluar.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se energjia elektrike e shpenzuar në katër komunat veriore të Kosovës faturohet te qytetarët e pjesës tjetër të Kosovës në shumën prej 8 milionë euro në vit, si mund ta argumentoni ju se këto 8 milionë euro janë të papërballueshme për KEDS-in.

Pyetja ime është sa është bilanci financiar i KEDS, dhe në bazë të saj ne vijmë në përfundim se KEDS, nuk është në gjendje të mbuloj këto shpenzime që bëhen në pjesën veriore, por as sesi t'ju ngarkohet qytetarëve padrejtësisht.

Ajo në vazhdim shtroi pyetjen se pse nuk keni dërgua padi në pjesën veriore të Kosovës, ku gjykatat funksionojnë, në bazë të cilit parim është nxjerrë vendimi i vitit 2012, dhe në bazë të cilës formulë është bërë ndarja e pagesës në faturat e qytetarëve, dhe pas zbatimit të vendimit të gjykatës, në çfarë forme do të mendoni që ta përmbylleni këtë çështje njëherë e përgjithmonë, e jo duke kërkuar buxhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës?

Duda Balje parashtroi pyetje për përfaqësuesit e bordit të ZRRE-së, nëse vendimi i ZRRE-së 399 i dt. 6 shkurt 2012, nuk paraqet bazë për faturimin e shpenzimeve të energjisë për pjesën veriore te qytetarët te pjesët tjera të vendit, cila është baza për një faturim të tillë dhe si është bërë ky faturim përkatësisht cilat janë metodat e faturimit dhe kush është fajtor për të gjitha këto?

Saranda Bogujevci tha se përveç rekomandimeve që i ka bërë Avokati i Popullit për këtë raport, duhet të sqarohet mes kujt është marrë vendim, kush e ka diskutuar që me ju bartur qytetarëve të pjesës tjetër që t'i paguajnë faturat e rrymës së shpenzuar në veri të Kosovës. Më shqetëson fakti se me çfarë të drejtë merret një vendim dhe ju drejtohet një barrë qytetarëve dhe për këtë qytetarët nuk njoftohen fare.

Duhet dikush të marrë përgjegjësi, nuk arsyetohet në asnjë mënyrë se është arritur një Marrëveshje në Bruksel, për me ia vu barrën pjesës tjetër të qytetarëve të Kosovës.

Lirije Kajtazi tha se çështja që po trajtohet këtu ka të bëjë me çështjet kapitale të shtrirjes së sovranitetit të Republikës së Kosovës në të gjitha pjesët e saj, konkretisht në veri.

Ne, si komision, e shqyrtojmë Raportin në fjalë të IAP-it, nuk kemi hamendje se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut, duhet ta gjejmë bashkërisht mënyrën si institucione të Kosovës, se çfarë forme do të gjejmë, që ajo mendësi e mohimit në pjesën veriore të vendit, me u kompensuar në forma të ndryshme.

Janë dhënë alternativa nga Avokati edhe nga ZRRE, fajet që i ka pjesa politike duhet t'i marrë, këtu ka koston e vet edhe shtrirja e sovranitetit ka shumë probleme që janë përtej këtij forumi.

Unë propozoj që kjo pikë të dërgohet për shqyrtim në Kuvend dhe të shikohet me krejt kompleksitetin e punës edhe çështjes që e ka.

Arsim Janova tha se ne, si anëtarë të bordit, qysh në shkurt të këtij viti e kemi njoftuar Komisionin Funksional të Kuvendit të Kosovës, se tash fillon procesi tarifar për periudhën 5 vjeçare të ardhshme. Komisioni Funksional i Kuvendit, të propozojë të bëhet një zgjidhje përmes Kuvendit dhe Qeverisë, sepse përgatitjet për tarifa bëhen 7 apo 8 muaj më parë. Pajtohem që transparenca është dashur të jetë më e madhe, regjistrimi i kompanisë serbe nuk është bërë me fajin e saj.

Prej 1 dhjetorit 2017, e kemi hequr atë pjesën që është bërë për pagesën për veriun që është 3.5% në bazë të përlllogaritjes që është bërë në totalin e saj.

Është një proces që duhet të ketë përmirësime patjetër, nuk ka kurrfarë Marrëveshje për vendim për pagesë për pjesën veriore, sa jemi ne në dijeni.

Sa i përket çështjes së çmimit të energjisë elektrike në Kosovë, ato janë më të ulëtat në rajon, tani i kemi tarifat e njëjta verë dimër, por dallimi është ditë dhe natë.

Sa i përket kompensimit nuk mund të prejudioj, derisa nuk kemi përbërje të plotë të Bordit, por çdo vendim që vjen prej gjykatës lidhur me çështjen e kompensimit duhet të zbatohet.

Sa i përket pyetjes se cila është baza për faturim, tha se lidhur me këtë, sqarime të nivelit profesional do të jep zyrtari nga ZRRE-ja, Petrit Pepaj.

Petrit Pepaj tha se vendimi 399 ka të bëjë me zvogëlimin e humbjeve dhe nuk ka të bëjë me ndarje të territorit, janë parametra rregullator të cilët ju kanë paraqitë të licencuarve për me pas efikasitet dhe zvogëlim të kostos për 5 vitet e ardhshme.

Rregullatori ka një bazë ligjore të cilën duhet me e respektuar, ne i respektojmë ligjet, por nuk bëjmë ligje.

Ai theksoi se është paditur ndërmarrja e cila vepron në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Kosovës dhe se për këtë çështje eksitojnë dokumentet.

Sami Kurteshi tha se nëse Avokati i Popullit ka mundësi ta interpretojë paragrafin 39 të raportit.

Hilmi Jashari, në vlerësimin që është bërë në raportin në fjalë të IAP-it, është konstatuar jo vetëm shkelje e ligjit për Energjinë, por edhe të ligjeve të tjera duke përfshirë ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore.

Ajo çka po ju intereson të gjithëve dhe që është e rëndësishme është baza juridike e këtij vendimi që pastaj neve na ka nxitur t'i hymë trajtimit të kësaj çështje.

Në kohën kur ZRRE, ka marrë vendim i janë referuar humbjeve komerciale, që Ligji për Energjinë i ka në përkufizime, mirëpo humbjet komerciale flasin për vjedhje të energjisë elektrike, nuk mund të hynë në një kategori të tillë humbjet në veri dhe të arsyetohen me vendimin e vitit 2012, sepse vjedhjet si të tilla janë vepra penale dhe ato procedohen nga prokurori publik dhe trajtohen si të tilla.

Sa i përket kompensimit nëse nuk merren në konsideratë rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe pritet që gjykata të japë fjalën përfundimtare, mendoj se kemi një problem, sepse Kushtetuta dhe Ligji për Avokatin e Popullit, e kanë krijuar këtë mekanizëm përkatësisht për të shërbyer si mekanizëm komplementar për shkak të asaj që u përmend edhe të zvarritjes së procedurave gjyqësore për të ndihmuar sistemin edhe për të rivendosë të drejtën kundër shkeljeve, që në këtë rast ka ndodhur në mënyrë masovike.

Sidoqoftë është e interesit që të diskutohet problemi i kompensimit, që është imediat dhe duhet me ndodhur nga ZRRE, është detyrë e të gjithë neve me afua një zgjidhje të përshtatshme, e cila kishte mundur me e kursyer qytetarin nga shkeljet e mëtutjeshme.

Duda Balje sërish bëri pyetje se ku është marrë baza ligjore për atë vendim dhe metodën, si dhe pse nuk ka pasur transparencë në fatura lidhur me këtë pagesë, dhe kush është fajtorë për humbjet dhe për mos transparencën.

Petrit Pepaj tha se baza dhe metodat e kalkulimit janë të përcaktuara në rregullat e çmimeve. Janë 5 rregulla të cilat janë të obligueshme, e cila bazë rrjedh prej Ligjit për rregullatorin e energjisë, i cili ia jep autoritetin për të krijuar metodologji për përcaktimin e çmimeve të rrymës.

Sa i përket transparencës, ka qenë mirë të bëhej një rubrikë në faturë, e cila do të sqaronte se një pjesë e çmimit të faturës është për veriun, kjo transparencë nuk ka ndodhur.

Saranda Bogujevci tha se nuk është problem vetëm çështja e transparencës, por a janë pyetur qytetarët lidhur me pagesën shtesë, në çfarë forme merret vendim që i obligon qytetarët me një borxh, që nuk është shpenzim i tyre.

Lirije Kajtazi tha se sa i përket privatizimit të KEK-ut, kur është bërë a ka pasur në planin e vet investime të cilat së paku i amortizojnë humbjet në mënyrën që menaxhohen, a është investuar ndonjë herë, a duhet të kërkohet nga kompania investim në rrjet që është tepër i vjetruar dhe që është si njëfarë merimange që rrinë mbi kokat e qytetarëve.

A janë kërkuar burime alternative me rastin e privatizimit, që është dashur të ishte një lloj kushti?

Mexhide Mjaku-Topalli u tha se do të respektohet vendimi që ka dalë nga gjykata, sa % do të lirohen bizneset dhe familjet në bazë të atij vendimi lidhur me ndërprerjen e faturimit për veriun.

Lidhur me çështjen se do të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike, për çfarë arsye do të bëhet kjo ngritje dhe a mos është kjo si mbulesë e këtij vendimi që është marrë më herët, dhe kur do të filloni dhe a do të na silleni raport për kompensimin e këtyre konsumatorëve që padrejtësisht janë obliguar me pagesë për tjerët prej vitit 2012.

Luljeta Veselaj tha se derisa ekipet e inkasantëve hynë nëpër shtëpitë-familjet tona, pa një leje pa patrullë të policisë, a veprojnë njëjtë edhe në shtëpitë e qytetarëve në pjesën veriore dhe çka ndodh?

Arsim Janova, do të mundohemi se në të ardhmen për tarifat e reja që do të vinë në fatura të jemi sa me sqarues, është konstatim i Avokatit të Popullit se ka pasur shkelje të drejtave të njeriut tani presim edhe vendimin e gjykatës.

Besim Sejfiqaj tha se ZRRE ka punuar me diskutime publike, kanë qenë të informuara të gjitha strukturat e shtetit, prej Kuvendit, Komisioneve të ndryshme, Ministria e Energjetikës dhe gjithë faktorët e tjerë dhe kanë ardhur te këto vendime, po bëhet fjalë për një vendim që është marrë në harmonizim me të gjitha strukturat e tjera shtetërore, sot jemi këtu dhe fajtori është në mesin tonë, brenda këtij shteti të brishtë që po mundohemi ta forcojmë bashkërisht, por mos u orientoni te një strukturë ose të një organizëm, sepse është strukturë shtetërore e përgjithshme.

Arsim Janova, tha se për rekomandimin nr. 3 (tre) të IAP, derisa Kuvendi nuk e kompletton bordin e ZRRE-së, nuk mund të japim përgjigjeje.

Në fund të diskutimit për këtë pikë të rendit të ditës, kryetarja, Duda Balje, konstatoi se:

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjet e mbajtura më 12 dhjetor dhe 18 dhjetor 2017, shqyrtoi Raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjie elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto:

R E K O M A N D I M E

I. Kuvendi i Republikës së Kosovës të shqyrtojë në seancë plenare, çështjen e faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

II. Kuvendi i Republikës së Kosovës të miratojë 3 (tre) rekomandimet që dalin nga raporti i lartpërmendur dhe të nxjerrë vendim, si vijon:

1. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), urgjentisht të ndalë praktikën e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës, te konsumatorët në pjesën tjetër të vendit.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS-in, të gjejë një mënyrë alternative, për t'iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar të gjithë konsumatorët, në mënyrë të barabartë, sipas normave kushtetuese dhe ligjeve kundër diskriminimit.
3. ZRRE-ja, në pajtim me Ligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, të nxjerrë një vendim, me anë të të cilit do të miratohej zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve, të cilët, padrejtësisht, janë faturuar dhe vazhdojnë të faturohen për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore.

III. Arsyetimin e Rekomandimeve në seancën plenare të Kuvendit, do ta paraqesë Duda Balje, kryetare e komisionit.

A r s y e t i m

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në dy mbledhjet e mbajtura radhazi, ka shqyrtuar Raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjie elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2017, Komisioni Funkcional ka ftuar për raportim lidhur me këtë çështje Institucionin e Avokatit të Popullit, z. Hilmi Jashari.

Ndërsa, në mbledhjen e radhës, të mbajtur më 18 dhjetor 2017, Komisioni Funkcional ka ftuar për raportim lidhur me këtë çështje: z. Arsim Janova - U.D. kryesues dhe Besim Sejfiqaj, anëtar

në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). Në këtë mbledhje ishte i pranishëm edhe Avokati i Popullit.

Komisioni Funkcional, duke marrë parasysh konstatimet, se kjo mënyrë e faturimit të energjisë elektrike përbën shkelje të disa ligjeve, siç janë: Ligji nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë; Ligji nr. 05/L-085 për energjinë elektrike; Ligji nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve; Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi; Ligji nr. 04/L-121 për mbrojtjen e konsumatorit, dhe duke vepruar në pajtim me fushëveprimin e komisionit, i rekomandoi Kuvendit të vendosë sipas rekomandimeve të lartpërmendura.

2. Të ndryshme

Duda Balje tha se kemi pasur një kërkesë nga Komisioni për Integritet Evropian që të caktohet një anëtar në grupin punues të formuar nga Komisioni për Legjislacion për shqyrtimin e Rregullores së Kuvendit.

Kërkesa ka qenë e ngutshme dhe me qenë se znj. Mexhide Mjaku Topalli, kishte qenë e caktuar edhe legjislaturën e kaluar, e kam propozuar që të jetë prapë anëtare e atij grupi punues.

Me pëlqim të anëtarëve të Komisionit, kryetarja, konstatoi se Komisioni vendosi që znj. Mexhide Mjaku-Topalli, ta përfaqësojë Komisionin, në grupin e punës të Komisionit për Legjislacion, për shqyrtimin e rregullores së Kuvendit.

Saranda Bogujevci i njoftoi anëtarët e Komisionit, se lidhur me peticionin e banorëve të fshatrave të Orllanit për furnizim me ujë, ka bërë një propozim amendament në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje

